**VENDIM**
**Nr. 555, datë 29.7.2022**

# PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE FONDIT GLOBAL PËR TË LUFTUAR SIDA-N, TUBERKULOZIN DHE MALARIEN, PËR PROGRAMIN "PËRSHKALLËZIMI DHE SIGURIMI I QËNDRUESHMËRISË SË PËRGJIGJES KOMBËTARE NDAJ HIV/SIDA-S DHE TUBERKULOZIT NË GRUPET KRYESORE TË POPULLATËS", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 219, DATË 12.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së grantit, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Global për të Luftuar SIDA-n, Tuberkulozin dhe Malarien, për programin "Përshkallëzimi dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së përgjigjes kombëtare ndaj HIV/SIDA-s dhe tuberkulozit në grupet kryesore të popullatës", miratuar me vendimin nr. 219, datë 12.3.2020, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

Ref.: EECA/DF/047-05/05/2022

5 maj 2022

Znj. Ogerta Manastirliu
Ministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë
**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë**
Rruga e Kavajës Nr. 1001 Tiranë, Republika e Shqipërisë

**Lënda: Granti: ALB-C-MOH**
**Përfituesi kryesor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë**
**Letër Zbatimi numër .5[1]**
**Rishikimi i Grantit**

E nderuar Znj. Manastirliu,

Referenca i bëhet Konfirmimit të Grantit të datës 21 shkurt 2020 (i ndryshuar herë pas here, "Konfirmimi i Grantit") ndërmjet Fondit Global për Luftën kundër SIDA-s, Tuberkulozit dhe Malaries ("Fondi Global") dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë ("Përfituesi Kryesor") në emër të Republikës së Shqipërisë ("Përfituesi i Grantit") për grantin ALB-C-MOH ("Granti"). Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në këtë Letër Zbatimi ose kontekst, të gjithë termat me shkronjë të madhe të përdorur në këtë Letër Zbatimi kanë kuptimin e përcaktuar në Konfirmimin e Grantit.

Fondi Global ka miratuar një zgjatje me fonde shtesë për Optimizimin e Portofolit. Si rezultat, kjo letër ndryshon datën e përfundimit të Periudhës së Zbatimit më 31 dhjetor 2024 dhe rrit Fondet e Grantit për periudhën e zbatimit me shumën 1,547,119 $ (dollarë amerikanë). Si rrjedhojë, kjo letër gjithashtu ndryshon Strukturën e Performancës dhe Buxhetin Përmbledhës të përfshirë në Skedulin I të Konfirmimit të Grantit dhe i është aneksuar këtij dokumenti.

Rrjedhimisht, ne propozojmë të bëhen ndryshimet e mëposhtme në Konfirmimin e Grantit:

1. Tabela në Seksionin 3 të Konfirmimit të Grantit fshihet dhe në këtë mënyrë zëvendësohet me tabelën e rishikuar që i aneksohet këtij dokumenti.
2. Struktura e Performancës fshihet dhe në këtë mënyrë zëvendësohet me Strukturën e rishikuar të Performancës që i aneksohet këtij dokumenti.
3. Buxheti Përmbledhës fshihet dhe në këtë mënyrë zëvendësohet me Buxhetin Përmbledhës të rishikuar që i aneksohet këtij dokumenti.

---

[1]Konfirmimi i Grantit u modifikua para Letrës së Zbatimit Nr. 1, datë 23 shtator 2020 ; Letra e Zbatimit Nr. 2,datë 3 dhjetor 2020; Letra e Zbatimit Nr.3, datë 15 qershor 2021 dhe Letra e Zbatimit nr. 4, datë 18 tetor 2021.

Përveç ndryshimeve nga kjo letër, të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Grantit mbeten të njëjta.
Ju lutem konfirmoni miratimin tuaj ndaj ndryshimeve të bëra këtu, duke nënshkruar këtë letër dhe duke rikthyer një kopje Fondit Global përmes sistemit të mesazheve elektronike. Këto ndryshime do të hyjnë në fuqi me nënshkrimin e kësaj letre nga një përfaqësues i autorizuar i Menaxhimit Financiar të Grantit të Fondit Global dhe një kopje elektronike e ekzekutuar plotësisht e kësaj letre do t'iu dërgohet për protokollin tuaj.
Faleminderit për përpjekjet tuaja të rëndësishme në luftën globale kundër HIV-it dhe SIDË-s dhe tuberkulozit.
Mbetemi në pritje të zbatimit të vazhdueshëm të suksesshëm të Programit

Me respekt,
(Nënshkrimi)

________________________

Dumitru Laticevschi
Menaxher Rajonal
Ekipi i Evropës Lindore dhe Azisë Qendrore
Divizioni i Menaxhimit të Granteve

Miratuar dhe nënshkruar:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së Shqipërisë në emër të Republikës së Shqipërisë

Nga:______________________________

Emri: Ogerta Manastirliu
Funksioni: Ministre e Shëndetësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë
Data:
Bashkëlidhur : Shtojca 1 -Tabela e konfirmimit të Grantit, e ndryshuar
Shtojca 2 -Struktura e Performancës për Grantin, e ndryshuar
Shtojca 3 -Buxheti Përmbledhës për Grantin, e ndryshuar

Në vëmendje të: Manjola Kola, Asistente Administratore, Mekanizmi Koordinues Vendor (CCM) Shqipëri
Annie Gjollma, Agjente e Fondit Lokal, Drejtuesi i Ekipit, Pricewaterhouse Coopers Shqipëri

---

Nënshkruar nga Menaxheri Financiar i Grantit, Departamenti i Menaxhimit të Financave të Grantit për njohjen e kësaj marrëveshjeje nga Fondi Global.

Nga:______________________________

Shevone Corbin

Menaxhere Financiare e Grantit,

PST

Data:

**Shtojca 1**

| | | |
|---|---|---|
| 3.1 | Vendi ose Rajoni pritës | Republika e Shqipërisë |
| 3.2 | Komponenti i sëmundjes | HIV/SIDA, Tuberkuloz |
| 3.3 | Titulli i programit: | Rritja dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së reagimit kombëtar ndaj HIV/SIDA-s dhe TB në Popullatën kyçe. |
| 3.4 | Emri i Grantit: | ALB-C-MOH |
| 3.5 | Numri GA: | 1854 |
| 3.6 | Fondet e Grantit: | Deri në shumën 3,361,856.44 dollarë amerikanë ose ekuivalentin e saj në monedha të tjera. |
| 3.7 | Periudha e zbatimit: | Nga 1 janari 2020 deri më 31 dhjetor 2024 (përfshirë) |
| 3.8 | Përfituesi kryesor: | Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë<br>Rr. Kavajës Nr. 1001<br>Tiranë, Republika e Shqipërisë<br><br>Në vëmendje të:<br>Znj. Ogerta Manastirliu<br>Ministre, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<br>Telefon: +35542362937<br>Faksimile:<br>Email: ogerta manastirliu@shendetesia gov.al |
| 3.9 | Viti fiskal | 1 janar deri më 31 dhjetor |
| 3.10 | Agjenti i Fondit Lokal: | PricewaterhouseCoopers, Shqipëri<br>Blvd. Dëshmorët e Kombit<br>Kullat Binjake<br>Kulla 1, kati i 10-të<br>Tiranë<br>Republika e Shqipërisë<br><br>Në vëmendje të:<br>Znj. Annie Gjollma<br>Telefon: +41587929100<br>Faksimile:<br>Email: annie.gjollma@pwc.com |
| 3.11 | Kontakti i Fondit Global: | Fondi Global në luftën kundër AIDS-it, Tuberkulozit dhe Malaries<br>Kampusi i Shëndetit Global, Chemin du Pommier 40<br>1218 Grand-Saconnex, Gjenevë, Zvicër<br><br>Në vëmendje të:<br>Dumitru Laticevschi<br>Menaxher Rajonal<br>Divizioni i Menaxhimit të Grantit<br><br>Telefon: +41 58 791 1700<br>Faksimile: +41 44 580 6820<br>E-mail: dumitru.laticevschi@theglobalfund.org |

THE GLOBAL FUND

## Shtojca 2: Struktura e Performancës

| | |
|---|---|
| **Vendi** | Shqipëri |
| **Emri i Grantit** | ALB-C-MOH |
| **Periudha e Zbatimit** | 01 janar 2020 – 31 dhjetor 2024 |
| **Përfituesi Kryesor** | Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Shqipërisë |

| **Periudhat e raportimit** | Data e fillimit | 01-Jan-2020 | 01-Jan-2021 | 01-Jan-2022 | 01-Jan-2023 | 01-Jan-2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Data e përfundimit | 31-dhjetor-2020 | 31-dhjetor-2021 | 31-dhjetor-2022 | 31-dhjetor-2023 | 31-dhjetor-2024 |
| | PU përfshin DR? Përditësimi i progresit/ Kërkesa për disbursim | Po | Po | Po | Po | Jo |

## Qëllimet e programit, treguesit e impaktit dhe objektivat

1. Për të siguruar që Shqipëria të mbetet një vend me përhapje të ulët për TB dhe HIV.

| **Treguesi i impaktit** | **Vendi** | **Vlera bazë** | **Viti bazë dhe Burimi** | **Ndarja e kërkuar** | **2020** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIV I-9a(M): Përqindja e meshkujve që kanë marrëdhënie me meshkujt të cilët jetojnë me HIV | Shqipëri | 2% | 2019 IBBS (Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0,50%<br>Data e fundit: 01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 2.00%<br>Data e fundit: 31-Mar-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |

**Komente**

**1.** Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në anketën e re të IBBS të kryer në vitin 2019 në popullatën MSM( meshkuj që kanë marrëdhënie me meshkuj). Sondazhi është kryer në kryeqytetin Tiranë, Durrës dhe Elbasan, dhe madhësia e kampionit të arritur ishte 554. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e anketës IBBS të realizuar në vitin 2011 me vlerë 0.5%. Sondazhi u krye në kryeqytetin, Tiranë, dhe madhësia e kampionit ishte 200. Objektivi për vitin 2021 ishte vendosur bazuar në bazën e IBBS 2011 dhe ishte planifikuar të raportohej bazuar në mbikëqyrjen treguese. Strategjia Kombëtare e SIDA-s 2020-2025 u finalizua në vitin 2021 dhe objektivat për vitin 2023 janë rishikuar dhe renditur me objektivat e NSP-së. Është planifikuar të kryhet IBBS në vitin 2023 dhe për vitin 2023 rezultatet do të raportohen bazuar në IBBS. Numëruesi: Numri i MSM-ve që rezultuan pozitivë për HIV Emëruesi: Numri i MSM-ve të testuar për HIV (numri i MSM-ve i përfshirë në madhësinë e kampionit).

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIVI-10(M): Përqindja e punëtorëve të seksit që jetojnë me HIV | Shqipëri | 0.6% | 2019 IBBS (Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0,50%<br>Data e fundit: 01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 2.00%<br>Data e fundit: 31-Mars-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |

**Komente**

2. Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në sondazhin e ri të IBBS të kryer në vitin 2019 në popullatën FSW(punonjëset e seksit që jetojnë me HIV). Sondazhi është kryer në kryeqytet, Tiranë. Metodologjia e përdorur ishte kampionimi i përshtatshëm dhe madhësia e kampionit ishte 150. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e sondazhit IBBS të realizuar në vitin 2011, me vlerë 0%. Sondazhi u krye në kryeqytetin, Tiranë. Metodologjia e përdorur ishte kampionimi i përshtatshëm dhe madhësia e kampionit ishte 120. Objektivi për vitin 2021 u caktua bazuar në bazën e IBBS të vitit 2011 dhe ishte planifikuar të raportohej në bazë të mbikëqyrjen treguese. Strategjia Kombëtare e SIDA-s 2020-2025 u finalizua në vitin 2021 dhe objektivat për vitin 2023 janë rishikuar dhe renditur me objektivat e NSP-së . Është planifikuar të kryhet IBBS në vitin 2023 dhe për vitin 2023 rezultatet do të raportohen në bazë të IBBS. Numëruesi: Numri i SW(punonjëseve të seksit) i cili rezultoi pozitiv për HIV Emëruesi: Numri i SW të testuar për HIV (numri i SW- punonjëseve të seksit - i përfshirë në madhësinë e kampionit).

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIVI-11(M): Përqindja e personave që injektojnë drogë të cilët jetojnë me HIV | Shqipëri | 1.4% | 2019 IBBS (Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0,50%<br>Data e fundit: 01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 1.00%<br>Data e fundit: 31-Mars-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |

**Komente**

**3.** Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në sondazhin e ri të IBBS të kryer në vitin 2019 në popullatën me PWID (persona që injektojnë drogë). Sondazhi është kryer në kryeqyteti Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Berat. Madhësia e kampionit të arritur ishte 755. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e sondazhit të IBBS të realizuar në vitin 2011 me vlerë 0.5%. Sondazhi u krye në kryeqytetin, Tiranë, dhe madhësia e kampionit ishte 200. Objektivi për vitin 2021 ishte vendosur bazuar në bazën e IBBS 2011 dhe ishte planifikuar të raportohej bazuar në mbikëqyrjen treguese. Strategjia Kombëtare e SIDA-s 2020-2025 u finalizua në vitin 2021 dhe objektivat për vitin 2023 janë rishikuar dhe renditur me objektivat e NSP-së. Është planifikuar të kryhet IBBS në vitin 2023 dhe për vitin 2023 rezultatet do të raportohen bazuar në IBBS. Numëruesi: Numri i PWID-ve (persona që injektojnë drogë) që rezultuan pozitivë për HIV Emëruesi: Numri i PWID-ve (persona që injektojnë drogë) të testuar për HIV (numri i PWID-ve i përfshirë në madhësinë e kampionit).

| Treguesi i impaktit | Vendi | Vlera bazë | Viti bazë dhe Burimi | Ndarja e kërkuar | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIV I-3(M): Shkalla e vdekshmërisë nga TB për popullatën 100.000 | Shqipëri | 0.62% | 2018 Sistemi i regjistrimit jetësor ICD -9 | | N: 0.57000<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2021 | N: 0.55000<br>D: 0.00<br>P: 0,00%<br>Data e fundit:<br>15-07-2022 | N: 0.50000<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2023 | N: 0.50000<br>D: 0.00<br>P:0.00%<br>Data e fundit:<br>15-07-2024 | N: 0.45000<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2025 |

## Komente

4. Të dhënat bazë i referohen Programit Kombëtar të Tuberkulozit, sistemit të regjistrimit dhe raportimit të TB, viti 2018 dhe bazuar në sistemin e regjistrimit jetësor.

Numëruesi: Numri i rasteve të TB-së, të reja dhe të përsëritura, të ndodhura gjatë vitit 2018 (18 vdekje të lidhura me TB-në). Sistemi i regjistrimit sipas Përkufizimit të ICD 9( klasifikimi ndërkombëtar i sëmundjeve). Emëruesi: Numri i njerëzve në popullsi x 100.000 Popullsia shqiptare në vitin 2018 ishte 2.870.324 (bazuar në INSTAT).

## Objektivat e Programit, Treguesit e Rezultatit dhe objektivat

1. Për të siguruar akses të barabartë në parandalimin, trajtimin, kujdesin dhe mbështetjen e tuberkulozit dhe HIV-it me cilësi të lartë, me fokus në popullatat kryesore të prekura (MSM, PWID, SW, PLWHA dhe persona të tjerë vulnerabil më të prekur nga epidemia e HIV-it dhe TB-së).
2. Sigurimi i përgjigjes së qëndrueshme ndaj HIV-it nëpërmjet forcimit të koordinimit, udhëheqjes dhe angazhimit financiar dhe politik të qeverisë.
3. Për të forcuar sistemet shëndetësore dhe komunitare që mundësojnë ndërhyrje parandaluese të bazuara në nevoja, të bazuara në prova dhe me kosto efektive për popullatat kryesore të prekura më së shumti nga epidemia e HIV-it dhe TB-së.

| Treguesi i impaktit | Vendi | Vlera bazë | Viti bazë dhe Burimi | Ndarja e kërkuar | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIV O-1(M): Përqindja e të rriturve dhe fëmijëve me HIV, të cilët dihen që janë në trajtim 12 muaj pas fillimit të terapisë antiretrovirale. | Shqipëri | 86.5% | 2018<br>Të dhënat e pacienteve | Kohëzgjatja e trajtimit ,<br>Mosha,<br>Gjinia | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 90.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2021 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 90,50%<br>Data e fundit:<br>15.07.2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 90.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2023 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 90.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 90.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2025 |

## Komente

1. Të dhëna nga dokumentet e pacientëve në QSUT (Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Pediatrisë). Periudha e raportimit është 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018, dhe treguesi llogaritet duke përdorur të gjithë pacientët që kanë filluar terapinë antiretrovirale në çdo kohë gjatë periudhës 12-mujore nga 1 janari 2017 deri më 31 dhjetor 2017. Numëruesi: Numri i të rriturve dhe fëmijëve që janë ende gjallë dhe marrin terapi antiretrovirale në 12 muaj pas fillimit të trajtimit. Emëruesi: Numri i përgjithshëm i të rriturve dhe fëmijëve që filluan terapinë antiretrovirale që priteshin të arrinin rezultate 12-mujore brenda periudhës raportuese (përfshirë ata që kanë vdekur që nga fillimi i terapisë antiretrovirale, ata të cilët kanë ndërprerë terapinë antiretrovirale, dhe ata të regjistruar si të humbur për të ndjekur deri në muajin 12). Grupi i pacientëve 2017 që filloi me trajtimin, ishte 89. Prej tyre, 77 ishin ende në trajtim 12 muaj më pas, 3 vdiqën, 9 e ndërprenë trajtim.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIV O-4a(M): Përqindja e meshkujve që raportojnë përdorimin e prezervativit herën e fundit që kanë kryer seks anal me një partner mashkull | Shqipëri | 74% | 2019 IBBS<br>(Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 70,00%<br>Data e fundit:<br>01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 79.30%<br>Data e fundit:<br>31-Mar-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |

## Komente

2. Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në sondazhin e ri të IBBS-së të kryer në vitin 2019 në popullatën MSM. Sondazhi është kryer në kryeqytetin Tiranë, Durrës dhe Elbasan, dhe madhësia e kampionit të arritur ishte 554. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e anketës IBBS të realizuar në vitin 2011 me një vlerë prej 64.9%. Sondazhi u krye në kryeqytetin, Tiranë, dhe madhësia e kampionit ishte 200. Një mbikëqyrje treguese u testua në 2021-22, dhe për vitin 2021 rezultatet do të raportohen bazuar në të dhënat e mbikëqyrjes treguese. Objektivi për vitin 2023 do të raportohet bazuar në sondazhin e IBBS-së që do të kryhet në vitin 2023. Numëruesi: Numri i MSM-ve që raportuan se një prezervativ ishte përdorur herën e fundit që kishin kryer seks anal me klientin e tyre të fundit. Emëruesi: Numri i MSM-ve që raportuan se kishin pasur seks anal me një partner mashkull në gjashtë muajt e fundit.

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HIV O-5(M): Përqindja e punonjësve të seksit që raportojnë përdorimin e një prezervativi me klientin e tyre më të fundit. | Shqipëri | 86.7% | 2019 IBBS<br>(Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Gjinia ,<br>Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 80,00%<br>Data e fundit:<br>01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 88.90%<br>Data e fundit:<br>31-Mars-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |
| **Treguesi i** | **Vendi** | **Vlera** | **Viti bazë** | **Ndarja e** | **2020** | **2021** | **2022** | **2023** | **2024** |

| impaktit | | bazë | dhe Burimi | kërkuar | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

## Komente

3. Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në sondazhin e ri të IBBS të kryer në vitin 2019 në popullatën e FSW-së (Punonjëset e seksit). Sondazhi është kryer në kryeqytet, Tiranë. Metodologjia e përdorur ishte kampionimi i përshtatshëm dhe madhësia e kampionit ishte 150. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e sondazhit e IBBS të realizuar në vitin 2011, me një vlerë prej 76.6%. Sondazhi u krye në kryeqytetin, Tiranë. Metodologjia e përdorur ishte kampionimi i përshtatshëm dhe madhësia e kampionit ishte 120. Një mbikëqyrje treguese u testua në 2021-22 dhe për vitin 2021 rezultatet do të raportohen bazuar në të dhënat e këtij vëzhgimi treguesi. Objektivi për vitin 2023 do të raportohet bazuar në anketën e IBBS –së që do të kryhet në vitin 2023. Numëruesi: Numri i FSW-ve që raportuan se ishte përdorur një prezervativ me klientin e tyre të fundit. Emëruesi: Numri i FSW-ve që raportuan se kishin pasur marrëdhënie seksuale në 12 muajt e fundit (numri i SW- punonjëset e seksit të përfshira në madhësinë e kampionit).

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| . | HIV O-6(M): Përqindja e personave që injektojnë drogë që raportojnë përdorimin e pajisjeve injektuese sterile herën e fundit që ata kanë injektuar | Shqipëri | 75.4% | 2019 Gjinia IBBS (Sondazhe të integruara biologjike dhe të sjelljeve ) | Mosha | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 76.00%<br>Data e fundit:<br>01-Mars-2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 79.10%<br>Data e fundit:<br>31-Mars-2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit: |

## Komente

4. Të dhënat bazë u përditësuan bazuar në sondazhin e ri të IBBS-së të kryer në vitin 2019 në popullatën me PWID (popullatën qe injekton drogë). Sondazhi është kryer në kryeqytetin Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Berat. Madhësia e kampionit të arritur ishte 755. Baza e mëparshme u bazua në rezultatet e sondazhit të IBBS-së të realizuar në vitin 2011 me një vlerë prej 74.6%. Sondazhi u krye në kryeqytet, Tiranë dhe madhësia e kampionit ishte 200. Një mbikëqyrje treguese sondazhi u testua në 2021-22 dhe objektivat e vitit 2021 do të raportohen në bazë të të dhënave të këtij sondazhi. Objektivi për vitin 2023 do të raportohet bazuar në sondazhin e IBBS-së që do të kryhet në vitin 2023. Numëruesi: Numri i PWID që raportojnë se kanë përdorur shiringë sterile herën e fundit që kanë injektuar droga. Emëruesi: Numri i PWID që raportuan se kanë injektuar drogë në muajin e fundit.

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TB O-1a: Shkalla e njoftimit të rastit për të gjitha format e TB-së për 100.000 persona - të konfirmuar bakteriologjikisht + të diagnostikuar klinikisht, raste të reja dhe të përsëritura | Shqipëri | 15.3 | 2018 Sistemi TB R&R Raporti menaxhimit vjetor | i | N: 15.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2021 | N: 14.50<br>D: 0.00<br>P: 0,00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2022 | N: 13.80<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2023 | N: 13.50<br>D: 0.00<br>P:0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2024 | N: 13.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00%<br>Data e fundit:<br>15.07.2025 |

## Komente

5. Të dhënat bazë janë të vitit 2018 (NTP) Programi Kombëtar për eliminimin e TB-së. I referohet të gjitha formave të rasteve të TB-së që janë të konfirmuara bakteriologjikisht ose të diagnostikuara klinikisht me TB aktiv nga një mjek klinik. Ai përfshin- raste të reja dhe të përsëritura që janë- (1) mostër dhe/ose kultura pozitive; ose mostër pozitive/kulturore negative (2) mostër dhe/ose kulturë negative; (3) mostër e panjohur/nuk është bërë; (4) raste ekstra-pulmonare të konfirmuara (5) raste të konfirmuara në bazë të rrezeve X, anomali. Numëruesi: Numri i të gjitha formave të rasteve të TB-së (d.m.th. të konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht) të raportuara [në një zonë të specifikuar 440 raste Emëruesi: Numri i personave në popullsinë e vitit 2018 ishte 2.870.324 (bazuar në INSTAT).

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 6 | TB O-5(M): Mbulimi i trajtimit të TB-së: Përqindja e rasteve të reja dhe të përsëritura që u njoftuan dhe u trajtuan midis numrit të llogaritur të rasteve të incidentit të TB-së në të njëjtin vit (të gjitha format e TB-së - të konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht) | Shqipëri | 87% | 2018 Raporti i OBSH-së | | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 88.00%<br>Data e fundit:<br>30.10.2021 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 88,50%<br>Data e fundit:<br>30.10.2022 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 89.00%<br>Data e fundit:<br>30.10.2023 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 89.00%<br>Data e fundit:<br>30.10.2024 | N: 0.00<br>D: 0.00<br>P: 89.00%<br>Data e fundit:<br>30.10.2025 |

## Komente

Të dhënat bazë janë nga sistemi i regjistrimit dhe raportimit të TB-së në NTP -Programi Kombëtar për eliminimin e TB- vitin 2018. Të gjithë pacientët e regjistruar dhe që kanë filluar trajtimin gjatë kësaj periudhe janë përfshirë në llogaritje. Numëruesi: Numri i rasteve të reja dhe të përsëritura që janë njoftuar dhe trajtuar. Emëruesi: Numri i llogaritur i rasteve të incidentit të TB-së në të njëjtin vit (të gjitha format e TB -sëtë konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht).

## Treguesit dhe objektivat e mbulimit

| Numri i treguesve të mbulimit | Treguesi i mbulimit | Vendi dhe fusha e objektivave | Vlera bazë | Viti bazë dhe Burimi | Ndarja e kërkuar | Përfshirja ne rezultatet GF | Lloji i grumbullimit | 01-janar-2020 31-dhjetor-2020 | 01-jan-2021 31-dhjetor-2021 | 01-jan-2022 31-dhjetor-2022 | 01-jan-2023 31-dhjetor-2023 | 01-jan-2024 31-dhjetor-2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | |

**Programe parandaluese gjithëpërfshirëse për MSM**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | KP-1a(M): Përqindja e meshkujve që kanë marrëdhënie me meshkuj të përfshirë në programe të parandalimit të HIV-it - paketa e përcaktuar e shërbimeve | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:1.03<br>D:7.60<br>P:15.6% | Raportet e vitit 2019 | | Jo | | N: 96.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 1104.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 2200.00<br>D: 7060.00<br>P: 31.2% | N: 2500.00<br>D: 7060.<br>P: 35.4% | N: 3000.00<br>D: 7060<br>P: 42.5% |

## Komente

4. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është përfshirë në bazë të vlerësimit të madhësisë 2019. Paketa e shërbimeve përfshin ofrimin e prezervativëve, lubrifikantëve, materialeve informuese, edukuese dhe komunikuese (IEC), testimin për HIV, testimin për infeksione seksualisht të transmetueshme (IST), Hep B dhe Testimin e Hep C, referimin tek shërbimet mjekësorë, psikolog / këshillim në terren dhe ndërhyrje komunikimi për ndryshimin e sjelljes. Shërbimet ofrohen në 5 rrethe. (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlore, Korçë) nga shoqata ALGBT. Klienti llogaritet si i arritur nëse merr të paktën prezervativë, lubrifikantë dhe këshillim në terren gjatë periudhave raportuese. Numëruesi: Numri i MSM-ve të arritura me programet e parandalimit Emëruesi: Numri i vlerësuar i MSM-ve. OJQ-ja ka një sistem UIC (kodi i identifikimit te përdoruesit) funksional.

## Treguesit dhe objektivat e mbulimit

| Numri i treguesve të mbulimit | Treguesi i mbulimit | Vendi dhe fusha e objektivave | Vlera bazë | Viti bazë dhe Burimi | Ndarja e kërkuar | Përfshirja ne rezultatet GF | Lloji i grumbullimit | 01-janar-2020 31-dhjetor-2020 | 01-jan-2021 31-dhjetor-2021 | 01-jan-2022 31-dhjetor-2022 | 01-jan-2023 31-dhjetor-2023 | 01-jan-2024 31-dhjetor-2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | KP-3a(M): Përqindja e meshkujve që kanë marrëdhënie me meshkuj të cilët kanë marrë një test HIV gjatë periudhës raportuese dhe dinë rezultatet e tyre | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:1.017<br>D:7.060<br>P:14.4% | Raportet e vitit 2019 | | Jo | | N: 90000<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 1035.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 1422.00<br>D: 7060<br>P: 20.1% | N: 1493.00<br>D: 7060<br>P: 21.1% | N: 1567.00<br>D: 7060<br>P: 22.2% |

## Komente

5. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore të vitit 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është përfshirë në bazë të llogaritjes së madhësisë të vitit 2019. Shërbimet ofrohen në 5 rrethe (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë dhe Korçë) nga shoqata ALGBT. Në Tiranë shërbimi ofrohet nëpërmjet SSP-së dhe qendrës së lëvizshme, ndërsa në rrethe nëpërmjet qendrës së lëvizshme dhe këshillimit ne terren. Numëruesi: Numri i MSM-ve të testuara. Emëruesi: Numri i vlerësuar i MSM-ve OJQ-ja ka një sistem UIC të vendosur.

**Programe parandaluese gjithëpërfshirëse për punonjëset e seksit dhe klientët e tyre**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | KP-1c(M): Përqindja e punonjëseve të seksit e arritur me anë të programeve parandaluese të HIV-it - paketa e përcaktuar e shërbimeve | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:235<br>D:2200<br>P:10.7% | Raportet e 2019 | | Jo | | N: 288.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 316.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 480.00<br>D: 2200<br>P: 21.8% | N: 580.00<br>D: 2200<br>P: 26.4% | N: 700.00<br>D: 2200<br>P: 31.8% |

## Komente

6. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është përfshirë në bazë të vlerësimit të madhësisë 2019. Për klient, paketa përfshin: prezervativë, lubrifikantë, materiale IEC, testim HIV, testim IST, Hep C dhe Hep B shërbime, referim në shërbimet mjekësore, psikolog/këshillim në terren dhe ndërhyrje komunikimi për ndryshimin e sjelljes. Klienti llogaritet si i arritur nëse merr të paktën prezervativë, lubrifikantë dhe këshillim në terren gjatë periudhës raportuese. Shërbimet ofrohen vetëm në Tiranë nëpërmjet SSP dhe këshillimit ne terren. Numëruesi: Numri i FSW-ve të arritura me programet e parandalimit Emëruesi: Numri i vlerësuar i FSW-ve. Emëruesi bazuar në ushtrimin e vlerësimit të madhësisë të kryer në vitin 2019. OJQ-ja, ka një sistem UIC në fuqi.

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | KP-3c(M): Përqindja e punonjëseve të seksit që kanë marrë një Testi për HIV gjatë periudhës së raportimit dhe i dinë rezultatet e tyre. | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:234<br>D:2200<br>P:10.6% | Raportet e 2019 | | Jo | | N: 219.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 240.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00% | N: 348.00<br>D: 2200<br>P: 15.8% | N: 370.00<br>D: 2200<br>P: 16.8% | N: 389.00<br>D: 2200<br>P: 17.7% |

## Komente

7. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore të vitit 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është i përfshirë në bazë të vlerësimit të madhësisë të vitit 2019. Shërbimet ofrohen vetëm në Tiranë nëpërmjet SSP-së dhe këshillimit në terren. Numëruesi: Numri i FSW-ve të testuara. Emëruesi: Numri i vlerësuar i Emëruesit të FSW-së bazuar në ushtrimin e vlerësimit të madhësisë të kryer në vitin 2019 OJQ-ja ka një sistem UIC funksional.

**Programe gjithëpërfshirëse parandaluese për personat që injektojnë drogë (PWID) dhe partnerët e tyre.**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | KP-1d(M): Përqindja e personave që injektojnë drogë, të arritur me programet e parandalimit të HIV-it- paketa e përcaktuar e shërbimeve | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:1477<br>D:6970<br>P:21.2% | Raportet e vitit 2019 | | Jo | | N: 1650.00<br>D: 6300<br>P: 26.2% | N: 1815.00<br>D: 6300<br>P: 28.8% | N: 2400.00<br>D: 6970<br>P: 34.4% | N: 2600.00<br>D: 6970<br>P: 37.3% | N: 2900.00<br>D: 6970<br>P: 41.6% |

## Komente

1. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore të vitit 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është përfshirë në bazë të llogaritjes së madhësisë të vitit 2019. Paketa e shërbimeve përfshin ofrimin e gjilpërave dhe shiringave, materialeve injektuese (tamponë, allçi, ujë steril, sterilizues), prezervativët, lubrifikantët, materialit IEC, testimit për HIV, testimit të IST-së, testimit të Hepatitit B dhe Hepatitit C, këshillimit të psikologut / kontaktit dhe sjelljes ndërrojnë ndërhyrjet e komunikimit. Shërbimet ofrohen në 6 rrethe (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Berat. Mënyrat e ofrimit të shërbimit përfshijnë SSP-në (pikat e stacioneve të shërbimit), njësitë e lëvizshme dhe këshillimin në terren. Klienti konsiderohet i arritur nëse merr të paktën tre nga shërbimet bazë të listuara (një prej tyre duhet të jenë gjilpëra dhe shiringa) gjatë periudhës raportuese. Numëruesi: Numri i PWID-ve të arritura me programet e parandalimit. Emëruesi: Numri i vlerësuar i PWID-ve. OJQ-ja që punon me PWID-në po përdor një sistem UIC për të raportuar mbi numrin e personave të arritur.

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **KP-3d(M): Përqindja e personave që injektojnë drogë që kanë marrë një test HIV gjatë periudhës raportuese dhe dinë rezultatet e tyre** | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:2007<br>D:6970<br>P:28.8% | Raportet e vitit 2019 | | Jo | | N: 2035.00<br>D: 6300<br>P: 32.3% | N: 2239.00<br>D: 6300<br>P: 35.5% | N: 2543.00<br>D: 6970<br>P: 36.5% | N: 2671.00<br>D: 6970<br>P: 38.3% | N: 2804.00<br>D: 6970<br>P: 40.2% |

## Komente

2. Të dhënat bazë përditësohen me rezultatin në fund të vitit 2019. Numëruesi përfshin rezultatet vjetore të vitit 2019 në vend të gjashtëmujorit të mëparshëm. Emëruesi është përfshirë në bazë të vlerësimit të madhësisë të vitit 2019. Burimi i përdorur janë raportet nga OJQ-të që ofrojnë Shërbime për Reduktimin e Dëmtimeve dhe MMT për numrin e PWID-ve të testuara. Shërbimet e reduktimit të dëmit ofrohen në 6 rrethe (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë dhe Berat) dhe MMT në 9 rrethe (Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Korçë, Berat, Fier, Shkodër dhe Sarandë). OJQ-ja që ofron shërbime NSP për PWID-në ka një sistem UIC funksional, ndërsa OJQ-të e MMT-së dokumentojnë emrat e klientëve. Duke pasur parasysh mungesën e një sistemi UIC të përdorur zakonisht nga strukturat që mund të ofrojnë testimin e HIV-it për PWID-të, ekziston një rrezik i mundshëm i mbiraportimit të rezultateve për shkak të dyfishimit. Numëruesi: Numri i PWID-ve të testuara, i cili përfshin ata të arritur nga programet e reduktimit të dëmit dhe ata që ndjekin programin MMT. Emëruesi: Numri i llogaritur i PWID-ve. Emëruesi bazuar në ushtrimin e vlerësimit të madhësisë të kryer në vitin 2019.

**Kujdesi dhe parandalimi i tuberkulozit**

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TCP-8: Përqindja e pacientëve të rinj dhe të përsëritur me TB, të testuar duke përdorur teste të shpejta të rekomanduara nga OBSH-ja në kohën e diagnostikimit. | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:<br>D:<br>P: | 2018 | | Jo | | N: 344.00<br>D: 4300<br>P: 80.00% | N: 354.00<br>D: 416<br>P: 85.1% | N: 364.00<br>D: 403<br>P: 90.00% | N: 357.00<br>D: 397<br>P: 90% | N: 348.00<br>D: 387<br>P: 90% |

## Komente

## Treguesit dhe objektivat e mbulimit

| Numri i treguesve të mbulimit | Treguesi i mbulimit | Vendi dhe fusha e objektivave | Vlera bazë | Viti bazë dhe Burimi | Ndarja e kërkuar | Përfshirja ne rezultatet GF | Lloji i grumbullimit | 01-janar-2020 31-dhjetor-2020 | 01-jan-2021 31-dhjetor-2021 | 01-jan-2022 31-dhjetor-2022 | 01-jan-2023 31-dhjetor-2023 | 01-jan-2024 31-dhjetor-2024 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

10. Regjistri i TB-së në regjistrin laboratorik të njësisë bazë të menaxhimit. Testet e shpejta të diagnostikimit molekular për pacientët me TB filluan në korrik 2019. Burimi i të dhënave për këtë do të jetë regjistri i TB-së në njësinë bazë të menaxhimit, regjistrat laboratorikë në Laboratorin Kombëtar të Referencës për TB-në. Numëruesi: Numri i pacientëve të saponjoftuar me TB të diagnostikuar me teste të shpejta të rekomanduara nga OBSH-ja.

Emëruesi: Numri i përgjithshëm i pacientëve të rinj dhe të përsëritur me TB.

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TCP-1(M): Numri i rasteve te njoftuara të të gjitha formave me TB-(d.m.th. të konfirmuara bakteriologjikisht + të diagnostikuara klinikisht), përfshin rastet e reja dhe të përsëritura | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:440<br>D:<br>P: | 2018 Sistemi i raportimit dhe regjistrimit të TB-së | Gjinia, Përcaktimi i rastit me TB, Mosha, Statusi i testit HIV | Jo | | N: 430.00<br>D:0.00<br>P:0.00 | N: 416.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00 | N: 403.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00 | N: 397.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00 | N: 387.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00 |

**Komente**

11. Numëruesi: Numri i të gjitha formave të rasteve të TB-së (të konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht) të njoftuara tek autoriteti kombëtar shëndetësor gjatë periudhës së raportimit. Emëruesi: Nuk aplikohet. Të dhënat bazë janë nga sistemi i regjistrimit dhe raportimit të TB-së, NTP-së për vitin 2018.

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TCP-2(M): Shkalla e suksesit te trajtimit- të gjitha format: Përqindja e rasteve me tuberkuloz, të gjitha format, të konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht, trajtohet me sukses (shërohet plus trajtimi i përfunduar) ndër të gjitha rastet e regjistruara me TBC për trajtim gjatë një periudhe të caktuar, raste te reja dhe te përsëritura | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:438<br>D:503<br>P:87.1% | 2018 Sistemi i raportimit dhe regjistrimit të TB-së | Gjinia, Mosha, Statusi i testit HIV | Jo | | N: 0.00<br>D:0.00<br>P:87.5% | N: 0.00<br>D:0.00<br>P:88.0% | N: 0.00<br>D:0.00<br>P:88.5% | N: 0.00<br>D:0.00<br>P:89.0% | N: 0.00<br>D:0.00<br>P:90.0% |

**Komente**

9. Të dhënat bazë janë nga sistemi i regjistrimit dhe raportimit të TB-së, NTP-së. Numëruesi: Numri i të gjitha formave të rasteve të TB-së (d.m.th. i konfirmuar bakteriologjikisht plus të diagnostikuar klinikisht) në një periudhë të caktuar, të cilët më pas u trajtuan me sukses (shuma e kategorive të rezultateve të OBSH-së "të shëruara" plus "trajtimi i përfunduar"). Emëruesi: Numri total i të gjitha formave të rasteve të TB-së (të konfirmuara bakteriologjikisht plus të diagnostikuara klinikisht) të regjistruara për trajtim në të njëjtën periudhë.

**Trajtim, kujdes dhe mbështetje**

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | TCS-1(M): Përqindja e personave që jetojnë me HIV, të cilët marrin aktualisht terapi antiretrovirale | Vendi: Shqipëri<br>Mbulimi: Kombëtar | N:581<br>D:1.400<br>P:41.5% | 2018 Të dhënat e pacientëve | Objektivi, Grupi i popullatës ne risk, Gjinia, Mosha, | Jo | | N: 7551.00<br>D:0.00<br>P:0.00 | N: 851.00<br>D: 0.00<br>P: 0.00 | N: 855.00<br>D: 1400<br>P: 61.1% | N: 944.00<br>D: 1400<br>P:67.4% | N: 1037<br>D: 1400<br>P: 74.1% |

**Komente**

8. Të dhënat bazë janë nga të dhënat e pacientëve në Qendrën Spitalore Universitare (Departamenti i Sëmundjeve Infektive dhe Departamenti i Pediatrisë) deri në fund të vitit 2018. Numëruesi: Numri i personave që marrin aktualisht terapi antiretrovirale në fund të periudhës raportuese. Emëruesi: Vlerësimi i PLHIV-së për vitin 2018.

## Masat gjurmuese të planit të punës

| Ndërhyrja | Aktiviteti kyç | Arritjet | Kriteret për plotësim | Vendi | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| | | | | | |

**Komente**

